

## **“Vlerësimi i Ndërhyerjes: Perspektivat lokale mbi ndërtimin e demokracisë në vëndet dhe territoret Pas-Jugosllave”**

### *Një konkurs për ese të hapura*

Me fondet nga Fondi Vëllezërit Rockfeller, projekti *Muabet* i Institutit për Studimet Ndërkombëtare Watson, po organizon një konkurs me ese të hapura për të vënë rëndësinë në vlerat e perspektivave lokale mbi përpjekjet ndërkombëtare për ndërtimin e demokracisë në ish-Jugosllavinë. Ftojme studentë, studiues, profesionistë, aktivistë, dhe veprimtarë të rajonit të dërgojnë ese të cilat analizojnë përmasat sociale, kulturore, politike ose ekonomike të përfshirjes ndërkombëtare në periudhën e tranzicionit. Ne jemi vecanërisht të interesuar në eset të cilat komunikojnë përvojën e të punuarit me organizatat ndërkombëtare ose të atyre që punojnë për këto organizata, në sektorin qeveritar ose jo-qeveritar, në mënyrë që të paraqesin perspektivat analitike mbi progresin e bërë gjatë viteve të fundit. Eset më të mira do të publikohen në anglisht. Më shumë sqarime jepen më poshtë.

Situata e deritanishme në Ballkanin Perëndimor shtron një pyetje të thjeshtë: A është e vlefshme ndihma e demokracisë së huaj? Shumë vlerësime ndërkombëtare e gjykojnë këtë ndihmë si të suksesëshme, duke u bazuar në disa tregues, si pjesëmarrja qytetare, ulja e dhunës ndër etnike, progresi socialo-ekonomik, dhe rritja e kapacitetit të shoqërisë civile. Ndërsa disa të tjerë arsyetojnë që këto projekte po dështojnë, duke përmendur rënien e partive reformiste dhe kthimin e nacionalistëve në Sërbë, trazirat gjerësisht të përhapura në Kosovë në Mars të 2004, lënia zvarrë e mosmarrëveshjeve mbi ndryshimet konstitucionale në Maqedoni mbas 2001, dhe diskutimet për një “Kolonizim Evropian” në Bosnje-Hercegovinë. Këto opinione të ndryshme vënë rëndësinë në dyshimet mbi procesin e demokratizimit, si dhe në vështirësitë për të vlerësuar rezultatet e përpjekjeve të ndihmës së demokracieve të jashtme.

Në ambientet akademike dhe ato të përcaktimit të politikave, ky vendim është i paqartë dhe dëshmon më tepër për zëniet partizane sesa për analiza të kujdesëshme. Ndërmjet retorikave ekstremiste në Ballkan, të cilat shikojnë vetëm suksesin ngadhënjës ose humbjen poshtëruese, dhe si rrjedhojë rekomandojnë receta me konkluzione të përgjithëshme. Po ashtu edhe realiteti i bazuar në terren – i parë nga prania ose përvoja, sidomos e banuesëve të këtyre vëndeve dhe territoreve e ardhëmjës e të cilëve është në diskutim – shpeshherë nuk merret parasysh ose është i papërfillshëm. Konkursi i esëve me temën “Vlerësimi i Ndërhyerjes: Perspektivat lokale mbi ndërtimin e demokracisë në vëndet dhe territoret Pas-Jugosllave” synon të trajtojë këtë çështje.

Eset duhet të jenë të gjata nga 6,000-7,000 fjalë dhe mund të dërgohen në anglisht ose në çdo gjuhë tjetër të rajonit. Ne inkurajojmë dërgimin e esëve në formatin elektronik por do të pranojmë edhe eset në leter. Gjithashtu ne do të pranojmë edhe eset e punuara nga bashkëautorë. Si pjesë e Fondit Vëllezërit Rockefeller që përqëndrohet mbi “vëndet kyçe”, në mënyrë parësore mirëpresim eset që trajtojnë çështjet e tranzicionit demokratik në Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, dhe Sërbë.

Ashtu siç theksohet edhe më sipër, ne jemi vecanërisht të interesuar në ato eset që janë bazuar në përvojën e bashkëpunimit ndërmjet individëve dhe organizatave të përfshira në procesin e tranzicionit demokratik. Disa nga pyetjet e mundëshme që eset mund të synojnë, të cilat ne mendojmë se kanë rëndësi në kuptimin e efektit, me qëllim ose pa qëllim, të ndihmës së demokracisë ndërkombëtare janë si vijonë:

Si ndikon prania e organizatave ndërkombëtare në shoqërinë civile? Për shëmbull, mundësia e punësimit në Organizatat Ndërkombëtare (ON) rritë mjeshtërinë punuese të një individi, duke ndikuar pozitivisht për shoqërinë në kohë afatgjate, apo dobëson Organizatat Jo Qeveritare (OJQ) duke mos i lënë shumë personel të kualifikuar për të punësuar?

Sa dinë organizatat ndërkombëtare për traditat e vëndit ku ata punojnë? Si e përvehtësojnë ata këtë ditori, dhe ç'farë janë faktorët që i pengojnë ata për të mësuar?

Si ndryshon kuptimi lokal i demokracisë nga kuptimi i dhuruesëve (donatorëve) dhe i punonjësëve ndërkombëtar? Si ndikon ky kuptimi lokal i demokracisë në formën e programeve ndihmëse për demokracinë?

Si ndikon organizimi i brendshëm dhe rregullat e Organizatave Ndërkombëtare në marrëdhëniet profesionale ndërmjet personelit vëndas dhe atij ndërkombëtar? Vecanërisht, organizimi i brendshëm i ON inkurajon apo diskurajon bashkëpunimin e marrëdhënieve profesionale ndërmjet personelit vëndas dhe atij ndërkombëtar?

Kur personeli vëndas i një ON ose i një organizate kombëtare sugjeron ide në formulimin, zbatimin, dhe vlerësimin e projekteve që zhvillojnë demokracinë, a është personeli ndërkombëtar i gatshëm për të dëgjuar dhe për ti vënë në jetë këto ide? Në ç'farë kushtesh dhe në ç'farë faze të projekteve që zhvillojnë demokracinë është personeli ndërkombëtar më i pranueshëm për sugjerimet lokale?

Këto pyetje janë vetëm sugjerime dhe ne inkurajojmë analiza më të gjëra të ndërhyrjes ndërkombëtare në rajon. Shëmbull i këtij mendimi, është një ese analitike e shkruajtur nga një amerikane praktikuese e demokracisë mbi bazën e përvojes së saj në Sanxhak, dhe mund të lexohet në këtë adres: [URL.....](#)

Të gjithat eset që do të dërgohen do të lexohen dhe vlerësohen nga një ekip ndërkombëtar, të cilët kanë përvojë të gjatë në këtë temë, ose në rajon, ose në të dyja. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve 10 eset më të mira do të botohen në anglisht, në një edicion special të një reviste ose në një volum të redaktuar. Autorët e suksesëshëm do të përfitojnë ndihmë financiare dhe teknike për rishikimin, përkthimin, dhe redaktimin. Dhe nëqoftëse fondet do të jenë të mjaftueshme, ata do të ftohen në një seminar ndërkombëtar për të paraqitur dhe për të diskutuar punën e tyre.